

Emri i departamentit	Detyrat funksionale	Arsimi dhe kualifikimet e shefave
<p>1</p> <p>Departamenti i Epidemiologjise dhe Kontrollit te Semundjeve Infektive</p>	<p>Koordinon kontrollin e semundjeve infektive ne vend dhe menaxhon situatat epidemiologjike te jashtezakonshme, shperthimet epidemike, koordinon raportimin ne kuader te ligjeve ne fuqi dhe rregullores nderkombetare te shendetin apo organizmave te tjere nderkombtare e te tjere sipas detyrimit te te vendit. Supervizon punen e punonjesve dhe drejton kerkimin shkecor ,kryen kerkime shkecore dhe kordinon edukimin ne vazhdim ne kete fushë. Kryen konsulencen kombetare per kontrollin e semundjeve ne vend si dhe nderkomnetar ekur i kerkohej sipas detyrimeve eke ka vendi. Supervizon monitorimin e standarteve ne ldihe me te gjitha fushat qe mbulon departamenti dhe propozon per ndryshimet e tyre.Koordinon aktivitetet per zhvillimin e qendruhem ne fushen e semundjeve infektiv ene Europen Juglindore</p>	<p>(CV) Silva Bino, Shef, Departamenti i Epidemiologjise dhe Kontrollit te Semundjeve Infektive , Instituti i shendetit Publik Tirane.</p> <p>Dr. Silva Bino mban titullin e profesores se asociuar te semundjeve infektive prane Universitetit Mjekesor te Tiranes. Dr.Siva Bino ka qene drejtore e Institutit te Shendetit Publik ne vitet 2000-2006. Kariera e saj eshte perqendruar ne strategjite e kontrollit dhe parandalimit te semundjeve infektive dhe perforcimin e sistemeve te survejances dhe vaksinimit ne vendet me te ardhura te pakta.</p> <p>Ajo ka permiresuar programet e mesiperme qysh prej vitit 2000 dhe ka ndihmuar ne vendosjen e sistemit te survejance sbazuar ne sindroma,(ALERT) dhe survejancen e gripit ne Shqiperi dhe ne vende te tjera te rajonit dhe ne bote.</p> <p>Ajo ka marre pjese ne koordinimin e nje sere iniciativash kombetare dhe nderkombetare te parandalimit te kontrollit te semundjeve infektive dhe zbatimit te IHR kryesisht ato te lidhura me poliomielin, fruthin, rubeolen, koleren, brucelozen, pandemine e gripit A (H1N1) 2009, semundjet qe transmetohen nga vektoret..</p> <p>Ajo ka qene dhe eshte konsulente e OBSH dhe agjensive te tjera te kombeve te bashkuara dhe te tjera nderkombetare duke sherbyer si antare e Grupit strategjik keshillimor te eksperteve per imunizimin prane drejtorit te pergjithshem te OBSH, si eksperte prane komitetit nderkombetar te rishikimit mbi funksionimin e rregullores nderkombetare te shendetit (IHR)dhe vleresimin e pergjigjes se OBSH ndaj pandemise se gripit A (H1N1) 2009 dhe me pas prane grupit keshillimor per pergatitjen ndaj pandemive prana drejtorit te pergjithshem te OBSH. Kohet e fundit ajo ka qene anetare e komitetit te IHR te emergjences mbi virusin Zika dhe komplikacionet e tij prane OBSH.</p> <p>Dr.Bino ka fituar titullin e mjekut te pergjithshem nga fakulteti i mjekesise i universitetit te Tiranes dhe me pas ate te specialistit te semundjeve infektive dhe epidemiologjise nga ky fakultet duke u specializuar me pas ne keto fusha ne universitetin e Nje Jorkut, Gjeneves, universitetin katolik te Leuvenit, Belgjike, dhe Shkollen Rolling te Shendetit Publik dhe Qendren e Kontrollit te Semundjeve ne Atalanta, ShBA.</p> <p>Ajo ka kryer studimet e doktoratures dhe ato pasuniversitare prane fakultetit te mjekesise te universitetit te Tiranes dhe me pas prane shkolles ne higjenes dhe semundjeve tropikale ne universitetin e Londres . Ajo ka publikuar nje sere artikujsh dhe raporte ne revistat kombetare dhe nderkombetare.</p>

2	<p align="center">Departamenti i Epidemiologjisë dhe Sistemeve Shëndetësore</p>	<p>Është përgjegjes për sigurimin e normalitetit të procesit administrativ dhe aktivitetit studimor e operativ të Departamentit. Ai është epror i drejtperdrejte për punonjësit e Departamentit.</p> <p>Është përgjegjes për përpilimin dhe zbatimin e vizionit, misionit, strategjisë dhe objektivave të Departamentit që drejton.</p> <p>Drejton dhe kontrollon në vazhdimësi zbatimin e detyrave të Departamentit konform planit strategjik-operacional afat-shkurter e afat-mesem të departamentit, të përpiluar nën drejtimin e tij në bazë të vizionit, misionit, strategjisë dhe objektivave të Departamentit, dhe të miratuar nga Drejtori dhe Këshilli Shkencor i ISHP-se.</p> <p>Vlerëson planet e punës kërkimore-shkencore të Departamentit në bazë të planeve të paraqitura nga vartësit e tij në përputhje me vizionin/misionin dhe strategjinë/objektivat, duke bashkërenduar planifikimin e punës edhe në bashkëpunim me ato të Departamenteve/sektoreve të tjera të ISHP-se. Planet e punës i dorëzohen Drejtorisë së ISHP-se për miratim. Siguron zbatimin në kohë dhe me cilësi të planeve të punës në Departament, duke siguruar kushtet objektive për realizimin e tyre.</p> <p>Mban lidhje të drejtperdrejte me Drejtorin e ISHP-se, merr prej tij urdhera dhe raportin në të për zbatimin e tyre.</p> <p>Përgjigjet për punën e vartësve të tij para Drejtorit të ISHP-se.</p>	<p>(CV) Eduard Kakarriqi Mban prej 2007 pozicionin Shef i Departamentit të Epidemiologjisë dhe Sistemeve Shëndetësore në Institutin e Shëndetit Publik, Tiranë dhe i punësuar në këtë institucion që prej vitit 1972. Diplomuar si Mjek i Përgjithshëm në 1971 dhe pas kësaj ka marrë diplome pasuniversitare në Mikrobiologji dhe Epidemiologji (1972-1973) dhe më pas Virologji (1973-1974) dhe master shkencor në Epidemiologji, Erasmus University Medical School, The Netherlands Institute for Health Sciences, Rotterdam, The Netherlands (Hollandë). Kualifikim 4 muor në National Institute for Vaccines and Sera Production, Pekin, China, Istituto Sieroterapico Milanese "Belfanti", Milano, dhe Istituto Sieroterapico e Vaccinogeno Toscano "Sclavo", Siena, Italy, për Bioteknologji Virale dhe Epidemiologji të Sëmundjeve Virale. Mban titujt Doktor i Shkencave dhe Profesor. Aktualisht punon gjithashtu si Pedagog Efektiv si dhe është Kryetar i Grupit Teknik Kombëtar të Imunizimit (National Immunization Technical Advisory Group, NITAG), Korrespondent Kombëtar i Projektit EMCDDA-IPA5 (Bashkimi Europian) mbi problemin e drogës në Shqipëri, Pika Fokale Kombëtare (National Focal Point) e Programit HANS (Health Adriatic Network Skills), Pika Fokale Kombëtare (National Focal Point) e Programit INTER-REG Shqipëri-Itali, Pika Fokale Kombëtare (National Focal Point) e Projektit EPISOUTH, Koordinator Kombëtar i Projektit të Survejancës të Sëmundjeve Infektive, Anëtar i Këshillit Botues të "Balkan review of Public Health", Kryetari i Qendrës Kombëtare të Grumbullimit të Informacionit për Drogën në Shqipëri. "Certifikate miënjohjeje" në kuadrin e 100-vjetorit të pavarësisë së Shqipërisë, e akorduar nga Ministri i Shëndetësisë, për kontributin e dalluar të dhënë ndër vite, për mbrojtjen e shëndetit publik, aftësitë e larta profesionale dhe dedikimin e admirueshëm civil, njerëzor e shoqëror (28.11.2012).</p>
---	--	---	---

<p>3</p>	<p>Deaprtamenti i Shendetit dhe Mjedisit</p>	<p>Pergjegjes per problemet e shendetit mjedisor ne departament per cilesin e ujit dhe sanitetit, cilesia e ajrit, siguria ushqimore dhe ushqyerja, zhurmat dhe fizika sanitare etj.</p> <p>Organizon dhe orienton koleget per problemet shkencore te departamentit (plane pune, tema studimore).</p> <p>Organizon, realizon dhe kontrollon ekspertizat sanitare per problemet e shendetit mjedisor.</p> <p>Organizon dhe kontrollon realizimet e monitorimit te mjedisit nga departamenti.(Ne perputhje te V.K.M Nr 103 , dt. 31.3.2002.)</p> <p>Konsulton, jep mendime, sqaron rekomandime per Agjensise Shteterore si p.sh projektligje, rregullore, broshura, dizertacione etj.</p> <p>Organizon, konsulton, bashkepunom ne trajnime te ekspertizes qe punojne ne Shendet Publik.</p> <p>Pregatit raportin perfundimtar per punën vjetore të departamentit .</p> <p>Kontrollon laboratoret e departamentit ne fushen e ujrave,ajritzhurmave, ushqimeveetj per llogariteaxhensiveshtetroredhetetetreteve.</p> <p>Harton dhe organizon seminare, Workshopeetj.</p> <p>Pjesemarje ne projekte kerkimore nacionale, internacionale etj.</p>	<p>(CV) Arben Luzati Shef i Departametit te Shendetit dhe Mjedisit ne Institutin e Shendetit Publik, Tirane.Eshte diplomuar si mjek ne vitin 1978. Prej Maj 1987 e deri tani mjek pranë Institutit te Shendetit Publik, Tirane. Aktualisht: Shef I Departamentit te Shendetit dhe Mjedisit, prane ISHP. Ne shtator të 1997 ka marr titullin Doktor Shkencave. Në prill të 2007 ka marr titullin Profesori Asociuar në fushën e mjeksisë. Pjesëmarrje në trajnime, seminare workshope ,konferenca ne Europë dhe nëAfrikë, por trajnimi më i plotë është në Mars-Shtator 2001 pranë universitetit të Barit në fushën e higjenës sanitare. Kam botuar monografi ,artikuj , abstrakte etj. Kam qënë udhëheqës shkencor si dhe anëtar i disa komisioneve shkencore pëmarrje doktorature.Anëtar i këshillit shkencor të ISHP-së</p>
-----------------	---	---	--

4	Departamenti i Promocionit Shendetesor	<p>Planifikon, organizon, drejton dhe analizon veprimtarinë e Departamentit të Promocionit Shëndetësor dhe të kabineteve të Edukimit dhe Promocionit Shëndetësor në rrethe. Drejton aktivitetet që synojnë forcimin e kapaciteteve kombëtare në fushën e promocionit shëndetësor. Organizon dhe drejton fushatat kombëtare ndërgjegjësuere për çështje të ndryshme shëndetësore, të organizuara nga ISHP.</p> <p>Drejton aktivitetet me karakter shkencor (studime shkencore, publikime shkencore, konferenca shkencore etj) në fushën e promocionit shëndetësor. Përcakton studimet në fushën e promocionit shëndetësor te cilave do t'u jepet prioritet. Dizenjon dhe drejton kryerjen e studimeve vlerësuese dhe diagnostikuese për të vlerësuar cilësinë dhe performancën e programeve të edukimit shëndetësor. Është personi përgjegjës i departamentit për komunikimin me median.</p> <p>Përfaqëson ISHP në grupët dhe komisionet nderinstitucionale per ceshtjet që lidhen me promocionin shëndetësor në Shqipëri. Zhvillon dhe mban marrëdhënie pune bashkëpunuese me institucionet, agjencitë, dhe organizatat që punojnë në fushën e shëndetit publik dhe promocionit shëndetësor. Vlerëson planet e punës kërkimore-shkencore të anëtarëve të DPSH. Supervizon stafin e Departamentit të Promocionit Shëndetësor në ISHP dhe të specialistëve të PSH në rrethe në zbatimin e qëllimeve, objektivave dhe aktiviteteve të programeve shëndetësore. Kujdeset për disiplinën në punë.</p>	<p>(CV) Gentiana Qirjako</p> <p>Mban pozicionin e Shefes së Departamentit të Promocionit Shëndetësor në Institutin e Shëndetit Publik dhe është njëkohësisht edhe pedagoge efektive në Departamentin e Shëndetit Publik në Fakultetin e Mjekësisë. Ka një karrierë 6-vjeçare në Institutin e Shëndetit Publik dhe 10 vjeçare në Fakultetin e Mjekësisë.</p> <p>Në vitin 1998 është diplomuar si mjeke e përgjithshme në Fakultetin e Mjekësisë në Universitetin e Tiranës. Është specializuar në degën “Shëndet Publik” dhe aktualisht ka titullin “Profesor”. Ka një eksperiencë të gjatë në fushën e kërkimit shkencor në shëndet publik dhe promocion shëndetësor. Ka drejtuar studime kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe ka punuar si konsulente për çështje të Mbrojtjes Shëndetësore në Delegacionin Evropian në Shqipëri. Është autore e disa artikujve shkencorë kombëtarë dhe ndërkombëtarë, e teksteve për studentët e Fakultetit të Mjekësisë, si dhe autore tekstesh mësimore për shkollat e mesme. Gjithashtu është personi fokal kombëtar për çështjet e lëndimeve dhe dhunës në Shqipëri.</p> <p>Planifikon, organizon, drejton dhe analizon veprimtarinë e Departamentit të Promocionit Shëndetësor dhe të kabineteve të Edukimit dhe Promocionit Shëndetësor në rrethe. Drejton aktivitetet që synojnë forcimin e kapaciteteve kombëtare në fushën e promocionit shëndetësor. Organizon dhe drejton fushatat kombëtare ndërgjegjësuere për çështje të ndryshme shëndetësore, të organizuara nga ISHP.</p>
---	---	--	---

5	<p>Departamenti i Informacionit Shëndetësor, Teknologjisë dhe Komunikimit</p>	<p>Koordinon aktivitetet për mbarevajtjen e Buletinit të ISHP-se, përfshirë filtrimin, përzgjedhjen, editimin e artikujve në mënyrë që artikujt të jenë në përputhje me udhëzimet për të botuar në këto organ. Gjithashtu, i jep rishikimin final artikujve në versionin shqip dhe anglisht të buletinit. Si anëtar i Bordit të Albanian Medical Journal, realizon të njëjta procese në këto organ të ISHP. Ben përjekje që të zbatohet VKM Nr. 327, datë 28.5.2014 mbi “Percaktimin e formatit dhe mënyrës së mbledhjes e të raportimit të të dhenave nga ofruesit e shërbimeve të kujdesit shëndetësor, publik ose privat”, VKM që e percakton ISHP-ne si “magazinen e të gjithë informacionit shëndetësor” në vendin tone. Në këto kuader, shefi i Departamentit nxit dhe shtyn përpara procesin e zbatimit të indikatorëve shëndetësorë ECHI, krijimin e regjistrave kombëtare të sëmundjeve me interes dhe impakt të lartë publik si dhe kontakton vazhdimisht institucione të ndryshme, në emër të ISHP-se, në mënyrë që t’i kujtoje ata lidhur me detyrimin ligjor për zbatimin e VKM-se. Kujdeset për mbarevajtjen e faqes web të ISHP-se si dhe për përditësimin e kësaj faqeje me informacionet e nevojshme në shërbim të popullatës apo profesionistëve të ndryshëm. Përqipet të përmirësojë teknologjinë e Departamentit apo dhe të ISHP nëpërmjet lobimeve përkatëse sipas rastit. Kujdeset që informacionet që ofrohen apo komunikohen nga ISHP të jenë në një format të përshtatshëm, të thjeshtë dhe të kuptueshëm për audiencën. Mbikqyr funksionet e redaktimit të materialeve të ndryshme shkencore që prodhohen nga ISHP. Ofron ekspertizën e tij në aktivitetet të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare në funksion të përbushjes së misionit të ISHP. Siguron mbarevajtjen e punëve në departament, ndan dhe organizon punën si dhe zgjidh mosmarrëveshjet midis punonjësve sipas rastit. Mbikqyr dhe vlerëson performancën e punonjësve dhe përbushjen e objektivave të departamentit, në përputhje me misionin dhe strategjinë e ISHP-se</p>	<p>(CV)Ervin Toçi, Shef, Departamenti i Informacionit Shëndetësor, Teknologjisë dhe Komunikimit, Instituti i Shëndetit Publik Tiranë . Mban pozicionin e Shefit të Departamentit të Informacionit Shëndetësor, Teknologjisë dhe Komunikimit, në Institutin e Shëndetit Publik (ISHP). Ka një karrierë pothuajse 12 vjeçare pranë ISHP-së. Është diplomuar si mjek i përgjithshëm pranë Fakultetit të Mjekësisë, Tiranë. Ka kryer Master në Shëndet Publik gjatë 2004-2005 në Tiranë, Master Ndërkombëtar në Shëndet Publik në Izrael 2006-2007, Specializim në Shëndet Publik pranë Fakultetit të Mjekësisë, Tiranë, gjatë viteve 2008-2009. Gjithashtu, ka përfunduar studimet e Doktoraturës në Maastricht të Hollandës gjatë periudhës 2010-2015. Përveç trajnimit në Shëndet Publik, është trajnuar në paketat statistikore dhe në një sërë fushash të tjera me interes për shëndetin publik. Aktualisht është Korrespondenti Kombëtar i Shqipërisë për Qendrën Europiane të Monitorimit të Drogave dhe Varësisë nga Drogat (EMCDDA). Eksperienca e mëparshme e punës në fushën e shëndetit publik përfshin angazhimin në shumë studime dhe projekte kombëtare dhe lokale, si dhe disa studime ndërkombëtare. Është ekspert vlerësues i aktivitetëve të ndryshme të QKEV dhe autor i mjaft artikujve shkencorë në revista ndërkombëtare me faktorë impakti.</p>
---	--	--	--

